

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6715
E hënë, 26 shtator 2022
çmimi 0.40

Ministri i Mbrojtjes: Koha për ta sanksionuar Serbinë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GREVA NË ARSIM VAZHDON, NUK LËVIZIN NGA QËNDRIMET
AS QEVERIA, AS SBASHK-U | FAQE 4-5

KURTI NUK OFRON ZGJIDHJE PËR GREVËN, THELLON KRIZËN DUKE I SULMUAR SINDIKALISTËT



Të dielën është bërë një muaj që kur ka filluar greva në arsim dhe deri më tani ende nuk është arritur një marrëveshje në mes të qeverisë dhe SBASHK-ut. Të dielën kryeministri Kurti, në vend se të ofrojë zgjidhje, sërish i ka sulmuar me fjalë drejtuesit e sindikatave duke i quajtur sindikalistë

të PAN-it. Në lidhje me këtë deklaratë të kryeministrit Kurti, sekretari i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, ka theksuar se deklaratat e tilla i shohin si tentim të qeverisë për ta thelluar hendekun mes tyre dhe sindikatës si dhe për të vazhduar edhe më tej greva

AKTUALE



PRESIDENTI UKRAINAS U OFRON
GARANCI USHTARËVE RUSË QË
DORËZOHEN F. 2

VDES PROFESORI UNIVERSITAR
BELUL BEQAJ F. 3

KRASNIQI: BARAZIA GJINORE
50-50 NË PDK, MUNDËSI E
JASHTËZAKONSHME PËR
POTENCIALIN E RI QË E KEMI F. 6

EKONOMI



KOMUNAT PA INVESTIME KAPITALE,
BIZNESET PA PUNË F. 7

PATATJA E PESTOVËS NJIHET JO
VETËM NË KOSOVË, POR EDHE NË
VENDET E RAJONIT F. 6

SPORT



PONTE FITON DERBIN PRIZRENAS,
PEJA MPOSHTI YLLIN F. 10



RAMA NË OKB: SHQIPËRIA NUK DO TË NDALET SË LUFTUARI PËR PASTËRTINË E UÇK-së

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Presidenti ukrainas u ofron garanci ushtarëve rusë që dorëzohen



KIEV, 25 SHTATOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka ofruar garanci ushtarëve rusë që dorëzohen te forcat ukrainase. Ai u ka bërë thirrje rusëve ta shmangin mobilizimin e pjesshëm ushtarak të vendit të tyre. Në fjalimin e natës të 24 shtatorit, të cilin e mbajti në gjuhën ruse, Zelensky ofroi garanci për rusët që janë kapur robër derisa luftonin në Ukrainë. "Ukraina garanton tri gjëra për çdo ushtar rus që dorëzohet. Së pari, do të trajtoheni në mënyrë të civilizuar, në përputhje me të gjitha konventat. Së dyti, askush nuk do t'i dijë rrethanat e dorëzimit tuaj, askush në Rusi nuk do ta dijë se dorëzimi juaj ishte vullnetar. Dhe, së treti,

nëse keni frikë të ktheheni në Rusi dhe nuk dëshironi një shkëmbim, ne do të gjejmë një mënyrë për ta garantuar këtë", tha Zelensky. Presidenti ukrainas tha se mobilizimi i pjesshëm i Rusisë, i cili synon t'i mbështesë forcat ruse që kanë luftuar në Ukrainë që nga pushtimi i paprovokuar i Moskës në shkurt dhe që, së fundmi, kanë pësuar pengesa të mëdha ushtarake në lindje të Ukrainës, është një "krim". Presidenti rus Vladimir Putin më 21 shtator njoftoi për mobilizimin ushtarak në mënyrë që të forcohet pushtimi i paprovokuar i Ukrainës dhe pasi forcat ruse pësuan humbje në fushëbetje. Ai më 24 shtator nënshkroi amendamentet që ashpërsuan

dënimet për rusët që dorëzohen vullnetarisht ose që refuzojnë të luftojnë, duke i bërë këto veprime të dënueshme me 10 vjet burg. Mobilizimi, tash për tash, thuhet se është i pjesshëm, dhe thërret 300 000 rezervistë rusë që t'i bashkohen luftës. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes të Rusisë, shtetit me sipërfaqen më të madhe në botë, një mobilizim i plotë ushtarak do të nënkuptonte përfshirjen e forcës rezervë prej 25 milionë personash. Sipas ligjeve ruse, burrat dhe gratë nga mosha 18 deri në 60 vjeç teorikisht mund të thërriten si rezervistë, varësisht nga rangjet e tyre. Pushtimi rus i Ukrainës ka nisur më 24 shkurt.

Policia ruse bllokoi protestat kundër mobilizimit ushtarak, arreston mbi 700 persona

MOSKË, 25 SHTATOR - Policia ruse shpërndau protestat paqësore që u organizuan në disa qytete për ta kundërshtuar shpalljen e mobilizimit të pjesshëm ushtarak nga presidenti rus Vladimir Putin.

Më 24 shtator policia arrestoi më shumë se 700 njerëz në më shumë se 30 qytete në gjithë vendin.

Në Moskë u arrestuan mbi 300 persona, sipas organizatës OVD-Info, një grup i të drejtave të njeriut që monitoron arrestimet politike në Rusi.

Protestat nisën brenda pak orësh pasi Putini shpalli dekretin për mobilizim ushtarak më 21 shtator.

Policia u vendos në të gjitha qytetet ku ishin planifikuar protestat nga grupi opozitar Vesna dhe mbështetësit e liderit të burgosur të opozitës, Alexei Navalny. Forcat e rendit i arrestuan protestuesit, shumica prej tyre të rinj, para se të nisnin protestat.

Presidenti rus tha se mobilizimi do t'i përfshijë vetëm qytetarët që aktualisht janë pjesë e

forcave rezervë të ushtrisë dhe që kanë përvojë ushtarake, ndërsa zyrtarë rusë thanë se ky numër shkon deri në 300 000 qytetarë.

Putini, gjatë një adresimi drejtuar kombit, më 21 shtator, tha se mobilizimi do të nisë menjëherë.

Njoftimi për mobilizim të pjesshëm u bë një ditë pasi katër rajone ukrainase të pushtuara nga Rusia njoftuan për plane për mbajtjen e të ashtuquajturave referendume për t'iu bashkuar Rusisë.



Abazoviqi thotë se URA do të votojë për shkarkimin e Gjukanoviqit

PODGORICË, 25 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Malit të Zi, Dritan Abazoviqi, tha se Kuvendi duhet ta votojë iniciativën për shkarkimin e presidentit Milo Gjukanoviqi. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", ai tha se kjo do të dërgonte një mesazh të rëndësishëm politik.

Deputetët e shumicës parlamentare, Frontit Demokratik pro-rus, Demokratët dhe Lëvizja Qytetare URA, kanë nisur në Kuvendin e Malit të Zi, më 23 shtator, procedurën për shkarkimin e presidentit Milo Gjukanoviqi. Ata pretendojnë se Gjukanoviqi ka shkelur Kushtetutën gjatë procedurës për emërimin e mandatarit për



formimin e qeverisë. "Tashmë jemi një shumicë e sapokonstituuar, e cila mbështet formimin e një qeverie të re, por është mjaft e larmishme me

subjekte të ndryshme politike, që kanë vizione të ndryshme. Zgjidhja me siguri do të vijë në zgjedhje, por nuk është presidenti ai që do të vendosë se

kur do të zhvillohen ato zgjedhje", tha Abazoviqi.

Pas rrëzimit të qeverisë së Dritan Abazoviqit më 20 gusht, tri partitë që fituan shumicën në zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi ranë dakord që Miodrag Lekiq të jetë mandatar për përbërjen e qeverisë së re. Por, ato nuk i dorëzuan nënshkrimet e 41 deputetëve - sa kanë bashkërisht në Kuvendin prej 81 ulësesh. Gjukanoviqi e refuzoi propozimin që Lekiq të jetë mandatar për formimin e qeverisë së re të këtij vendi, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme. Ai, në të njëjtën kohë, propozoi shkurtimin e mandatit të përbërjes aktuale të Kuvendit të

Malit të Zi, për t'u hapur rrugë zgjedhjeve të reja.

Partitë e shumicës parlamentare kundërshtuan zgjedhjet e reja dhe vazhduan të këmbëngulin që Gjukanoviqi duhet ta pranojë Lekiqin mandatar, dhe një ditë pas përfundimit të afatit i dorëzuan 41 nënshkrimet e tyre në mbështetje të kandidaturës së Lekiqit.

Abazoviqi tha në intervistë se ka diskutuar edhe me zyrtarë amerikanë edhe "akuzat se Rusia financoi fshehtas Frontin Demokratik në vitin 2016 dhe ndoshta në 2018". Ai tha se financimi i paligjshëm i partive politike duhet të jetë pjesë e agjendës në luftën kundër korrupsionit.

Vdes profesori universitar Belul Beqaj


PRISHTINË, 25 SHTATOR - Të dielën është ndarë nga jeta në moshën 65 vjeçe profesori universitar Belul Beqaj të cilit i është dhënë lamtumira e fundit në varrezat e qytetit në Prishtinë.

Dr. Belul Beqaj lindi në Prizren

më 1957, ku i kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Beogradit, përkatësisht në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa ka

doktoruar në Fakultetin Shkenca Politike të Maqedonisë së Veriut.

Ka qenë autor i dhjetëra punimeve publicistike-shkencore, pjesëmarrës në konferenca të shumta brenda dhe jashtë Kosovës.



Nënshkrimi i marrëveshjes Beograd - Moskë, ministri Mehaj: Koha për ta sanksionuar Serbinë

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Serbia dhe Rusia kanë nënshkruar marrëveshje për koordinimin e politikës së jashtme. Marrëveshja e cila u nënshkrua nga ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Nikola Selaković dhe nga ai i Rusisë, Sergey Lavrov, ka nxitur reagime të shumta.

Lidhur me këtë marrëveshje ka reaguar edhe ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj. Mehaj në "Twitter" ka shkruar se është koha për ta sanksionuar Serbinë.

"Kandidati kryesor për t'u anëtarësuar në BE - Serbia - nënshkroi një marrëveshje për ta koordinuar politikën e saj të jashtme me MPJ-në e Rusisë. Për lajme që kërcënojnë sigurinë në rajon dhe më gjerë! Koha për ta sanksionuar Serbinë!", ka shkruar Mehaj.

Për nënshkrimin e kësaj marrëveshje ka reaguar edhe raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola Von Cramon, e cila e ka quajtur skandal të rëndë, duke thënë se ky është një sinjal se Bashkimi Evropian duhet t'i ngrijë



bisedimet me Serbinë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Edhe drejtori i Institutit KIPRED, Lulzim Peci, ka komentuar marrëveshjen e nënshkruar në mes të Serbisë

dhe Rusisë për koordinimin e politikës së jashtme. Peci ka thënë se kjo tregon se këto dy vende janë batakqi dhe se qëllimet e vërteta të politikave të tyre të jashtme nuk kanë dallim prej njëra-tjetrës, por

shpërfaqja e tyre është në proporcion me fuqitë e tyre ushtarake.

Ish-ambasadori ka shtuar se "Ballkani i hapur" nuk mund të bëhet me aleatë të Rusisë së Putinit dhe se me marrëveshjen

e ditës së djeshme duhet të kuptohet që ajo tanimë është e vdekur. "Çfarë bën sot Putini me këto referendume në qytete dhe fshatra të Ukrainës është njëjtë çfarë ka bërë Millosheviqi në fillim të '90-tave në Kroaci dhe Bosnjë. Këtu ka vetëm një dallim, atë që Millosheviqi i bënte dhe thoshte e nuk po i bëj, ndërsa Putini po e bën këtë hapur. Serbia me veprimet e saj e kërcënonte sigurinë në Ballkan dhe në Evropë, ndërsa Rusia është duke e kërcënuar sigurinë dhe rendin ndërkombëtar. Nënshkrimi i marrëveshjes së djeshme në mes të Selakovićit dhe Lavrovit tregon se këto dy vende janë batakqi dhe se qëllimet e vërteta të politikave të tyre të jashtme nuk kanë dallim prej njëra-tjetrës, por shpërfaqja e tyre është në proporcion me fuqitë e tyre ushtarake. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, është koha e fundit që si BE-ja dhe ShBA-ja, sidomos Shqipëria, të reflektojnë për politikën e tyre në raport me Serbinë", ka thënë Peci.

Musliu kritikon ashpër kryesinë e PDK-së, tregon pse nuk mori pjesë në konventën e partisë

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Konventa Programore e Partisë Demokratike të Kosovës që u mbajt këtë të shtunë ka ngjallur pakënaqësi brenda këtij subjekti politik. Deputetja Ganimete Musliu ka hedhur kritika ndaj kryesisë së PDK-së, teksa ka njoftuar arsyet e mospjesëmarrjes në këtë konventë.

Në "Facebook" ajo ka njoftuar se mungesa e saj në konventë ka të bëjë me mospajtimin për mënyrën e organizimit të konventës si në kohë, si në përmbajtje, si në përfaqësimin. Po ashtu, Musliu ka bërë me dije se nuk i duket e arsyeshme të bëhet pjesë e një konvente ku nuk përmenden ish-themeluesit e PDK-së, Hashim Thaçi e Kadri Veseli. "Nuk e shoh të arsyeshme të bëhem numër në një konventë e cila nuk e thotë as edhe një fjalë të vetme kundër padrejtësive që po u bëhen ish-liderëve dhe ish-themeluesve, krenarisë së

PDK-së dhe të Kosovës, Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. PDK-ja ka shkëlqyer me heshtje në këtë drejtim duke krijuar huti dhe pasiguri në elektorat", ka shkruar ajo.

Musliu ka thënë se në emër të reformave në parti "po shkatërrohen historia, tradita, identiteti ynë politik dhe dinjiteti ynë njerëzor". "Reformat janë të mirëpritura, por nuk reformohet një parti duke mohuar vlerat mbi të cilat u themelua, vlerat mbi të cilat e qeverisi dhe e rindërtoi vendin. Çdo parti duhet të hapet dhe të bëhet shtëpi ku gjeneratat e reja do të angazhohen, por pa e mohuar kontributin dydekadësh të aktivistëve dhe kuadrove të cilët ishin mburrja dhe krenaria e partisë dhe e Kosovës", ka deklaruar Musliu. Deputetja e ka akuzuar kryesinë aktuale të PDK-së se po injoron çdo përpjekje për debat të brendshëm, "duke u vetëkënaqur në 'lavdinë' e tyre momentale".





GREVA NË ARSIM VAZHDON, NUK LËVIZIN NGA QËNDRIMET AS QEVERIA, AS SBASHK-u

Kurti nuk ofron zgjidhje për grevën, thellon krizën duke sulmuar sindikalistët

Të dielën është bërë një muaj që kur ka filluar greva në arsim dhe deri më tani ende nuk është arritur një marrëveshje në mes të qeverisë dhe SBASHK-ut. Të dielën kryeministri Kurti, në vend se të ofrojë zgjidhje, ai sërish i ka sulmuar me fjalë drejtuesit e sindikatave, duke i quajtur sindikalistë të PAN-it. Në lidhje me këtë deklaratë të kryeministrit Kurti, sekretari i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, ka theksuar se deklaratat e tilla i shohin si tentim të qeverisë për ta thelluar hendekun mes tyre dhe sindikatës si dhe për të vazhduar edhe më tej greva

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 25 shtator - Kryeministri Albin Kurti të dielën sërish ka drejtuar akuza në drejtim të drejtuesve të sindiktave për grevën në arsim. Kurti u tregua i ashpër me SBASHK-un duke i quajtur ata sindikalistë të PAN-it. "Është për të ardhur keq se si shkollimi po mbahet peng. Përshtypja ime, pas të gjitha takimeve, bëhet fjalë për një inat anti qeveritar prej sindikalistëve të PAN-it të cilëve u është ndalur sahati më 5 qershor 2017. Aty iu ka ngelur sahati. Duan t'i bëjnë shërbim PAN-it në opozitë, duke bërë grevën armë kundër qeverisë. Është keq se sa shumë po humbim", u shpreh kryeministri Kurti. Sipas tij,

asnjë kërkesë e qeverisë për Këshillin Grevist nuk ka vlejtur. Kurti thotë se ka përshtypjen që po bëhet fjalë për një inat anti-qeveritar. "Po ashtu, këtë bindje e ka edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne nuk duam të bojkotohet shteti, sepse shkolla është shteti. Të gjitha kërkesat tona për Këshillin Grevist dhe për SBASHK-un nuk kanë vlejtur. Ata i kanë refuzuar të gjitha ofertat tonë. Ne duam që mësimi të fillojë sa më parë, që do të thotë se është dashur të fillojë më 1 shtator. Jam i bindur se nxënësit duan të shkojnë në shkollë, jam i bindur se prindërit duan që fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë, jam i bindur që edhe mësimdhënësit duan të japin mësim nëpër shkolla", ka thënë Kurti të dielën pasi ka votuar

për zgjedhjet e brendshme të LV-së.

Në lidhje me këtë deklaratë të kryeministrit Kurti, sekretari i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, ka theksuar se deklaratat e tilla i shohin si tentim të qeverisë për ta thelluar hendekun mes tyre dhe sindikatës si dhe për të vazhduar edhe më tej greva. "Sindikalistë janë 25 mijë anëtarë të SBASHK-ut dhe këta sindikalistë në kohën kur Ramush Haradinaj ishte kryeministër i PAN-it, kanë bërë tri javë grevë për të drejtat e tyre. Kurti po mendon që përmes këtyre deklaratave ta thellojë edhe më shumë hendekun mes sindikatës dhe qeverisë nga frika se mos rastësisht po ndërpritet greva", ka theksuar ai.

Ymeri tutje shtoi se kërkesat e tyre janë të drejta dhe legjitime

dhe se është e papranueshme që të quhen se janë nga partitë politike. "Kjo po shihet si një tentim i qeverisë për ta penguar dialogun dhe për të vazhduar grevat, sepse kërkesat janë shumë të drejta dhe legjitime dhe të quhen se janë nga kjo parti apo tjetra, janë të papranueshme", ka deklaruar Ymeri për "Telegraf"-in.

Ai shtoi se greva do të përfundojë varësisht nga dialogu me Qeverinë e Kosovës.

"Kur ta marrë Këshilli Grevist i BSPK-së vendimin dhe konsideron se janë plotësuar kushtet për ndërprerjen e grevës, anëtarësia e SBASHK-ut besoj se do t'i bindet vendimit që merr Këshilli Grevist i BSPK-së", ka thënë Ymeri.

Deri në janar mësimdhënësit, sikurse edhe shërbyesit e tjerë publikë, do të marrin shtesa prej 50 eurove që i ka premtuar qeveria Kurti me pakon e re mbështetëse ndaj inflacionit. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës nga data 25 gusht ka nisur grevën në sektorin publik në vend. Ata po

kërkojnë hartim dhe hyrje në fuqi sa më shpejt të Ligjit të Pagave, plotësim-ndryshimin e Ligjit mbi Skemat Pensionale dhe pagesë 100 euro deri në miratimin e Ligjit të Pagave. Ndaj deklaratës së Kurtit, i cili sindikalistët i quajti njerëz të PAN-it, kanë reaguar përfaqësues të opozitës.

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se në vend se të ulet e të bëjë zgjidhje, Kurti paska vendosur sërish t'i thumbojë mësuesit. Ajo ka kërkuar nga kryeministri Kurti që të gjejë zgjidhje pasi është kryeministër i vendit. "Dobët kryeministër, dobët. Në vend se të ulet e të bëjë zgjidhje, Kurti paska vendosur edhe sot t'i thumbojë mësueset dhe arsimtarët tanë. Njëherë njerëzit e LV-së e quajtën kryesindikalistin njeri të Serbisë, e sot kryeministri i paska quajtur sindikatat 'sindikata të PAN-it'. Si duket Kurti e ka problem ta kuptojë që në Kosovë ka organizata, sindikata, medie, shoqata të pavarura të cilat nuk nënshtrihen. Si duket e ka

Rama në OKB: Shqipëria nuk do të ndalet së luftuari për pastërtinë e UÇK-së

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), ka thënë se Shqipëria nuk do të ndalet së luftuari për pastërtinë e luftës çlirimtare të Kosovës dhe rishikimin e Rezolutës së Këshillit të Evropës në mbështetje të raportit famëkeq të tregimtarit Dick Marty. “Ne nuk do të ndalemi kurrë së nderuari të vërtetën e lirisë së Kosovës dhe askush, në emër të askujt, nuk mund të hedhë asnjë grimë baltë mbi ata që dhanë jetën për pavarësi”, ka thënë Rama

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

TIRANË, 25 SHTATOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të

Bashkuara (OKB) për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ku ka thënë se raportuesi i Këshillit Evropës (KiE), Dick Marty, ishte dashur të paguhet si tregimtar dhe jo si raportues i KiE-së. Sipas Ramës, Gjykata

Speciale është themeluar mbi raportin e Martit. “Ish-presidenti i Kosovës është arrestuar pa aktakuzë dhe kishte pritur një vit në paraburgim derisa formalisht u ngrit aktakuza ndaj tij”, ka thënë Rama në OKB.

“Të gjithë ju, imagjinojeni për një moment, presidenti juaj ose kryeministri, udhëheqësit e vendeve tuaja, të merret në paraburgim në një vend të tretë për një vit të tërë pa asnjë aktakuzë zyrtarisht nga një trup i krijuar dhe i sponsorizuar nga një komunitet i vendeve demokratike”, ka thënë ai.

Më tej, Rama ka shtuar se në aktakuzën ndaj Thaçit dhe pjesëtarëve të tjerë nuk ka asnjë fjalë nga “Fantazi e plotë” e Dick Martyt.


“Shqipëria nuk do të ndalet së luftuari për pastërtinë e luftës çlirimtare të Kosovës dhe rishikimin e Rezolutës së Këshillit të Evropës në mbështetje të raportit famëkeq të tregimtarit Dick Marty. Ne nuk do të ndalemi kurrë së nderuari të vërtetën e lirisë së Kosovës dhe askush, në emër të askujt, nuk mund të hedhë asnjë grimë baltë mbi ata që dhanë jetën për pavarësi”, ka thënë Rama.

Ai ka rikujtuar se gjenocidi brutal në Srebrenicë dhe spastrimi etnik në Kosovë nuk do të harrohen kurrë.

Duke folur për dialogun Kosovë - Serbi, Rama ka thënë se asgjë nuk e ndryshon pozicionin e Shqipërisë se Serbia duhet ta njohë

Kosovën. Sipas Ramës, është koha që Kosova dhe Serbia t'i normalizojnë raportet në dialogun e mbështetur nga BE-ja dhe ShBA-ja që ta njohin njëra-tjetrën shtete të pavarur dhe të ecin së bashku në “Ballkanin e hapur”. “Është koha që ngërçi i dialogut të kapërcehet me kurajë, nga të dyja palët, për arritjen e një marrëveshjeje vendimtare të mbështetur nga BE/ShBA”, ka thënë Rama.

Rama e ka përfunduar fjalimin e tij duke u bërë thirrje Kosovës, Mali të Zi dhe Bosnjë Hercegovinës, që të bashkohen në nismën e “Ballkanit të hapur”. Përveç shteteve të Ballkanit Perëndimor, ai u ka bërë ftesë edhe Greqisë dhe Turqisë që të bëhen pjesë e kësaj nisme.



problem të kuptojë që ka njerëz që vendimet i marrin vetë. Si duket ka telashe të pranojë që jo të gjithë ia kanë frikën.

Kryeministër, ju jeni kryeministër i Kosovës, jo i LV-së. Fatkeqësisht, nuk po silleni si

i tillë. Jemi më 25 shtator e fëmijët tanë janë në shtëpi. Hapi dyert e shkollave, kryeministër! Çelësat i ke në dorë ti”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”.

Ish-ministrja e Arsimit, Hykmete Bajrami, ka dalë me një propozim për SBASHK-un

dhe qeverinë që të ndalet greva. Deputetja e LDK-së i ka rekomanduar SBASHK-ut ta pranojë ofertën e qeverisë për shtesën prej 50 eurosh, por kjo shtesë të vazhdojë deri më 31 dhjetor të këtij viti.

Ajo rekomandon që më 1 janar

të vitit 2023 të fillojë implementimi i Ligjit të Paga. Në rast se nuk hyn në fuqi ky ligj, Bajrami thotë që të planifikohet buxhet që shtesa prej 50 eurosh të vazhdojë deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Po ashtu, ish-ministrja e

Financave ka kërkuar nga qeveria të mos zbatojë ndëshkime në paga për muajin shtator. “I rekomandoj qeverisë t’i pranojë këto kërkesa. Shkollat dhe çerdhet të hapen të hënën”, ka shkruar deputetja Hykmete Bajrami në “Facebook”.

Patatja e Pestovës njihet jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet e rajonit

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka vizituar një bujk në komunën e Vushtrrisë i cili merret me kultivimin e patates. Ministri Peci ka theksuar se komuna e Vushtrrisë ka rritur të identifikohet me produktet e veta bujqësore, duke i paraprirë rajonalizimit natyror përmes kultivimit të patates. “Te Xheveti pashë një punë të mrekullueshme e një bujk të zellshëm e plot vullnet për sektorin e bujqësisë. Për të nuk ka të diela e, me të drejtë, pasi që

bujqësia nuk njihet pushim. Duke parë punën e bujqve tanë, edhe të dielat tona natyrisht shndërrohen në të diela pune”, ka thënë Peci. Ai ka theksuar se patatja e Pestovës njihet jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet e rajonit dhe gjen përdorim të gjerë në industrinë përpunuese të kësaj kulture. Ministri i Bujqësisë ka thënë se perimtaria për më shumë se një dekadë ka qenë kultura më pak e përkrahur edhe pse bilanci tregtar vazhdimisht ka figuruar negativisht. “Për

vetëm 1 vit e gjysmë përkrahjen për perimtarinë e kemi rritur për rreth 85 % në fushë të hapur dhe rreth 90 % për perimet në sera. Patatën këtë vit, së bashku me fasulet, grurin dhe misrin, i kemi cilësuar ndër katër produktet strategjike për sigurimin e ushqimit në rezerva familjare, duke i mbështetur me subvencionimin e naftës dhe plehërimit pranveror. Rritja për patatën këtë vit shënon 118 % rritje përmes Programit për Pagesa Direkte 2022”, ka deklaruar ministri Peci.



Drejtësia selektive njëetnike e Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë



Shkruan: Sali BISLIMI

Drejtësia selektive njëetnike e Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë nuk ka synim paqen në Ballkan.

Gjykata Penale Ndërkombëtare amnistion krimet serbe në Kosovë duke mos ngritur tribunalin për krimet e Millosheviqit që me ndihmën e Rusisë e bën gjenocidin dhe pastrimin etnik mbi shqiptarët e Kosovës. Kjo gjykatë po merret me disa trosha bukë dhe akuzon terrorizon

udhehëqësit e UÇK-së që u ndihmuan nga forcat e NATO-s për lirinë e vendit. Kjo drejtësi selektive njëetnike nuk ka synim paqen, sepse gjykon vlerat perëndimore të UÇK-së, vlerat e lirisë dhe faktorizon Serbinë fashiste që edhe sot botërisht mbështet Putinin kriminal në Ukrainë. Qytetarët serbë gjatë luftës në Kosovë masivisht ishin paramilitarë. Ata u ktheheshin në shtëpi në mëngjeset e hershme, sepse ishin natën në aksione për masakrimin e shqiptarëve. Kur për pajfjësini bëhet

gjykim, rezistenca është obligim.

Pa gjykimin e krimeve serbe në Kosovë nuk ka paqe afatgjate në Ballkan.

Kosova fle mbi varre nga gjenocidi turk dhe ai serb tani. Në çdo hap kemi nga një varr në tokën dardane dhe asnjëherë nuk ka pasur gjykatë për ata që kanë vrarë shqiptarë, pra për të krijuar paqe dhe për të marrë gjumi qetë në Kosovën tonë.

Mjaft më! Drejtësi për shqiptarët nëse duam paqe afatgjatë në Ballkan dhe kthim të shpejtë të presidentit Thaçi në atdhe!

Krasniqi: Barazia gjinore 50-50 në PDK, mundësi e jashtëzakonshme për potencialin e ri që e kemi

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës është ndër krenarë sot me potencialin e grave dhe të rejave që ka PDK-ja e të cilat me platformën e re për barazi të plotë gjinore 50-50 do ta kenë hapësirën e merituar në vendimmarrje.

Kreu i PDK-së ka thënë se barazia gjinore në vendimmarrje, 50/50, vizion dhe qëllim që do ta kenë tash e

tutje, nuk ka kuptim pa energjinë pozitive dhe përkushtimin e aktivisteve të reja të PDK-së. “Gjatë Konventës Programore të Gruas Demokratike të Kosovës kisha kënaqësinë të bashkëbisedoj me përfaqësueset e së ardhmes së PDK-së, Arbnora Salihun, Aurora Nurën, Dhurata Muharremin, Jona Arifin dhe Vlora Tahirin. Idetë dhe planet e tyre për Kosovën janë asgjë më pak sesa vlera të

jashtëzakonshme! Vërtet jam krenar me potencialin që kemi në mesin tonë”, ka thënë Krasniqi.

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se PDK-ja po hapet dhe po reformohet, por nuk tjetërsohet. “Gratë e vajzat e reja që po i bashkohen PDK-së do ta kenë mbështetjen dhe hapësirën që e meritojnë. Nuk ka rrugë tjetër”, ka theksuar Çitaku.



Abdixhiku: LDK-ja është siguria për zhvillimin e

SHTIME, 25 SHTATOR - Dega e Lidhjes Demokratike të Kosovës në Shtime ka mbajtur të dielën Kuvendin e Jashtëzakonshëm Zgjedhor, ku me shumicë votash delegatët e këtij kuvendi zgjedhën kryetar të degës Jetulla Rexhaj.

Në kuvend i pranishëm ishte edhe kryetari i LDK-së, Lumir

Abdixhiku, me bashkëpunëtorë, i cili në fjalën tij tha se sot po e shtojmë edhe një ditë feste të demokracisë në shtëpinë tonë politike. Më tej, kryetari Abdixhiku theksoi se kështu të bashkuar në ide e vizion të përbashkët, LDK-ja krijon siguri drejt fitoreve të reja, duke qenë vetë siguria për

zhvillimin e Kosovës.

Kryetari i sapozgjedhur i Degës së LDK-së në Shtime, Jetulla Rexhaj, pasi që i falënderoi delegatët për besimin, tha se bashkë me veprimtarë dhe struktura do të angazhohen maksimalisht për rritjen e LDK-së në Shtime. Me këtë rast, ai bëri thirrje që këtij

Komunat pa investime kapitale, bizneset pa punë



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Mitrovica e Jugut është vetëm një nga komunat e Kosovës që gjatë këtij viti nuk ka nisur asnjë projekt kapital të financuar nga Qeveria e Kosovës. Në Ligjin për Buxhet të vitit 2022 parashihen dhjetëra projekte kapitale në këtë komunë, përfshirë shenjzimin në komunikacion, rregullimin dhe riparimin e rrugëve, të shtretërve të lumenjve, pastaj investime në administratë, shëndetësi, arsim e deri te renovimi i stadiumit "Adem Jashari".

Nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, konfirmon shkurtimisht se në asnjërin prej këtyre projekteve nuk kanë nisur punimet. Sazan Ibrahim i nga Asociacioni i Komunave të Kosovës thotë se probleme nga mungesa e investimeve kapitale kanë gati të 38 komunat e vendit. "Në mungesë të investimeve as jeta e qytetarit nuk mund të përmirësohet. Në zhvillimin ekonomik lokal ndikon edhe qasja në rrugë, kanalizim, ujësjellës etj. Në mungesë të saj, pengohet edhe zhvillimi i kompanive private, të cilat janë promotorë jashtëzakonisht të mëdhenj të punësimit", thotë Ibrahim për "Radion Evropa e Lirë".

Në komunën e Suharekës, e

cila ndodhet rreth 80 kilometra larg Mitrovicës së Jugut, gjendet kompania private "Eurofamis", e cila merret me ndërtimtari. Pronari i kësaj kompanie, Ilir Bytyçi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se vitet e kaluara ka qenë i përfshirë në projekte kapitale të financuara nga shteti dhe se ka pasur mbi 120 punëtorë. Këtë vit thotë se nuk ka pasur oferta për tenderë dhe se numri i punëtorëve i ka rënë në 20. "Përveç numrit të punëtorëve, edhe puna e biznesit është vështirësuar", thotë ai.

Buxheti i shtetit të Kosovës këtë vit është mbi 2.7 miliardë euro. Nga kjo shumë, mbi 720 milionë euro janë planifikuar për shpenzime kapitale. Në raportin 6-mujor financiar të publikuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës thuhet se për projekte kapitale janë shpenzuar vetëm pak mbi 79 milionë euro dhe pranohet se ka normë më të ulët të ekzekutimit. Sipas raportit, në periudhën e njëjtë të vitit paraprak për të njëjtin qëllim janë shpenzuar rreth 129 milionë euro, kurse në vitin 2020 rreth 92 milionë euro. Nga vlerësimet e Institutit GAP, i cili monitoron punën e institucioneve të Kosovës, del se realizimi i investimeve

kapitale në gjysmën e parë të vitit 2022 është më i ulët në dekadën e fundit.

Pse kanë rënë investimet kapitale?

"Radio Evropa e Lirë" ka pyetur Ministrinë e Financave për arsyen e mosekzekutimit të mjeteve për projekte kapitale, por nuk ka marrë përgjigje.

Në raportin financiar thuhet se norma e ulët e ekzekutimit "është kryesisht rezultat i dinamikës së pagesës së faturave të fundvitit fiskal 2021, të cilave u është dhënë prioritet që të paguhen para datës 31 dhjetor 2021 dhe të mos barten në vitin vijues".

Bartja e pagesës së faturave të fundvitit në vitin vijues fiskal "zakonisht jep një pasqyrë më të lartë të shpenzimeve kapitale për gjysmën e parë të vitit" - gjë që nuk ka ndodhur këtë vit, thuhet në raport. Sipas tij, dinamika më e ulët e investimeve është edhe rezultat i ngadalësimit të punëve nga ana e operatorëve ekonomikë për shkak të rritjes së çmimeve të materialit ndërtimor.

Për kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, arsye e mosrealizimit të projekteve kapitale është, po ashtu, mosfunksionalizimi i

Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). "Aty ka qenë ajo hallka, ku për sa kohë nuk ka qenë i kompletuar bordi i OSHP-së", thotë Rafuna.

Organi Shqyrtues i Prokurimit për më shumë se një vit nuk ka qenë funksional. Në qershor të këtij viti Kuvendi i Kosovës ka votuar për përbërjen e re të bordit të tij.

Ky organ, që ndryshe njihet si Gjykata e Tenderëve, është institucioni kryesor që merret me shqyrtimin e tenderëve publikë.

Rafuna thotë se qeveria duhet të gjejë mënyra për t'i zhblokuar investimet kapitale sepse ka rënë qarkullimi financiar i bizneseve. Sipas tij, dinamika e ulët e realizimit të investimeve rrit shkallën e papunësisë dhe, rrjedhimisht, zvogëlon mirëqenien e qytetarëve.

Si mund të gjendet zgjidhja?

Autoritetet kompetente duhet t'i ndihmojnë bizneset e angazhuara në punë publike që ta përballojnë çmimin e lartë të produkteve, thotë Rafuna. "Këtë praktikë e kemi parë edhe në Shqipëri dhe në vende të tjera, ku qeveria ka subvencionuar nivelin e çmimit", thotë ai.

Nga Ministria e Financave e

Kosovës kanë thënë në fillim të këtij muaji se kanë hartuar Projektligjin për Punë Publike për ta përsheptuar dinamikën e zbatimit të investimeve kapitale në pjesën e dytë të vitit.

Ministri Hekuran Murati ka thënë se të gjitha punët publike do të mbështeten "me kompensim për çmimet e rritura", por nuk ka sqaruar se në çfarë forme ose me sa për qind.

Në Kosovë norma e inflacionit ka arritur në 13 për qind në muajin gusht, krahasuar me 0.2 për qind sa ka qenë në gushtin e vitit 2021, tregojnë të dhënat e Agjencisë së Statistikave. Vetëm kostoja e ndërtimit, këtë vit, ka pasur rritje për rreth 20 për qind krahasuar me vitin e kaluar.

Çmimi i çimentos, që është një nga materialet më të përdorura ndërtimore në Kosovë, është rritur tri herë.

Sipas përfaqësuesve të kompanive për prodhimin e betonit, çmimi i çimentos ka lëvizur nga 82 euro për ton, sa ka qenë në janar të këtij viti, në afër 130 euro.

Rritja e inflacionit në botë ka nisur vitin e kaluar për shkak të çrregullimeve në tregje që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit, por ka vazhduar me ritëm më të shpejtë pasi Rusia ka nisur luftën në Ukrainë në fund të shkurtit.


Jean Genet dhe tri ditët e kaluara në Shqipëri

Nga: Luan RAMA

I nisur nga Brindizi me një anije të linjës së transportit italian, "Rodi", Jean Genet, ende një shkrimtar i panjohur, por i pasionuar pas Proust-it dhe Baudelaire-it, po i afrohej bregdetit shqiptar, drejt "Santi Quaranta", siç tregon dhe ai në librin e tij "Ditari i një hajduti" (Journal d'un voleur). Askush nuk e dinte që ishte thjesht një dezertor i ushtrisë franceze në Marok, që si hajdut dhe homoseksual që ishte, nuk mund ta përballonte rreptësinë e ushtrisë, për më tepër që ishte graduar. S'dinte asgjë nga Shqipëria, ky vend i panjohur, përmes të cilit mendonte të depërtonte lehtësisht në pjesën tjetër Evropës, pa u shqetësuar nga policët që mund ta ridërgonin menjëherë në Francë.

Ishte korriku i vitit 1936. Një vapë e madhe nderej në portin e "Santi Quaranta" – siç e quanin në atë kohë, apo Saranda, ku doganieri shqiptar me atë rrobë ushtarake të shqyera fshihej në kolibën e tij, i bezdisur nga dielli që digjte. Në zbritje, doganieri që donte të mbaronte shpejt me ata pak udhëtarë, i hodhi një sy librezës ushtarake të tij, duke kuptuar se ishte një francez, në një kohë që në Shqipëri kishin filluar të vinin ca turistë francezë për të parë qytezën e Apollonisë, ku arkeologu Léon Rey vazhdonte çdo verë kërkimet e tij. "Jean Geijetti" – pëshpëriti ai duke duke lexuar emrin dhe duke parë librezën ushtarake të atij udhëtari të çuditshëm dhe të parruar, me një fytyrë vagabondi, i shoqëruar nga një bashkudhëtar, një austriak i quajtur Anton. "Jean Geijetti" – pëshpëriti përsëri ai me dyshim, duke parë dhe katër fleta të shqitura të një pasaporte me viza serbe. Dhe, për këtë nuk gabonte, por kjo ishte punë e Genet-it dhe jo e tij.

Po ç'mund të bënte Genet në Sarandën e zbrazët ku njerëzit ishin futur në shtëpitë e veta për t'i shpëtuar vapës. Kështu, me një barkë me qera, Genet, që kishte vjedhur në zbritje valixhen e një udhëtari, i drejtohet Korfuzit, siç na e tregon vetë ai, ku qëndron gjatë një nate dhe e kthejnë përsëri drejt Sarandës, ndërkohë që një përgjegjës i prefekturës së Parisit, Maurice Toesca, në shënimet e tij mbi "dosjen Genet" nuk shkruan për Sarandën po për Durrësin. Taesca shkruante se ai kishte gjetur mundësinë të merrte një leje-kalim nga konsulli italian në Nice, të përshkonte Italinë, të shkonte në Napoli e Brindizi dhe gjatë pesë ditëve që të shkonte pastaj në Tiranë, ku atje do të ndodhte e papritura e tij ... Ideja e Genet-it ishte të qëndronte



një natë dhe t'ia mbathte menjëherë drejt Jugosllavisë, ose nga Pogradeci, nga ku shkonin shumë turistë, përmes një rruge më të shkurtër e të këndshme, ose drejt Shkodrës dhe Malit të Zi. Duke ardhur rrotull në sheshin e Tiranës, me sytë e një hajduti që gjithnjë do të dojë të bëjë diçka, një polic e pikas dhe menjëherë e merr me vete në postë.

– Si e keni emrin Zotëri?
– Jean!
– Po mbiemrin?
– Geijetti!
– Pasaportën!

Genet i xori pasaportën dhe ia dha. Tjetri e shikonte me dyshim.

– Përse keni ardhur në Shqipëri?

– Për turizëm!
– Me çfarë merreni?

– Pa punë – kishte qeshur Genet ... shes libra buzë Senës – kishte shtuar pastaj ai, por e pa që polici s'po e kuptonte.

Polici mendoi një çast dhe i tha të ulej në stolin pranë. Ai hyri dhe pas pak doli me shefin e tij, i cili po e këqyrte nga koka tek këmbët sikur të kishte përpara tij një bataçqi apo një vrasës.

– Pra Jean Geijetti? ... Pasaporta false! – i kishte bërtitur ai para hundëve dhe kishte tërhequr brenda ndërtesës.

Gjithë atë ditë dhe natën, Genet e kaloi në policinë e Tiranës. Përmes një përkthyesi atij i thanë se hyrja ilegale dhe pa vizë dënohej me burg dhe se duhej të zhdukej brenda 24 orëve. Genet kishte një pamje moskokëçarëse, pasi as që i

bënte përshtypje burgu shqiptar, atij që kishte përjetuar që nga fëmijëria e tij veç "shtëpi korrektimi" dhe burgje për vjedhje të vogla.

Kështu Genet iu drejtua kufirit drejt Jugosllavisë, për çka, vetë Genet nuk shkruan rreth kësaj aventure, pasi në librin e tij autobiografik "Ditari i një hajduti" (Journal d'un voleur) këtë peripeci ai e ka kaluar thjeshtë me një fjalë, "Albanie", pasi peripecitë e tjera nëpër Ballkan e Evropë ishin më pikante. Në fakt, Toesca shkruan se ai kishte tentuar të hynte në Korfuz, por sapo e kishin parë atje, e kishin përzënë për mungesë vize. Letër-kalimi i konsullit italian për grekët ishte i pavlefshëm. Kështu, një ditë më vonë ai kaloi kufirin shqiptar drejt Malit të Zi, meqë u njoh në Mal të Zi me një vajzë malazeze, Olga Barbezet dhe sapo kishte shkruar në Beograd e kishin futur në burg për hyrje ilegale. Por, Genet s'donte t'ia dinte për këto peripeci, madje këto i pëlqenin. Dhe, pas një qëndrimi i mbyllur në një fshat ciganësh në të Serbisë pranë Beogradit, në "Oujitsë-Pojega", më së fundi, pas një qëndrimi në një qeli me një kroat, ai ia mbathi drejt Austrisë, por aventurat vazhdojnë pasi dhe austriakët e përzënë menjëherë. Më pas rruga e çoi në një mënyrë rokambolike në Bërno të Çekoslllovakisë, në Berlin, Poloni, në Anvers e më së fundi kthehet në Francë, pas një viti bredhjeje fenomenale: 8500 kilometra brenda një viti nëpër Evropë. Dhe, ai e thoshte me mburrje ngado se ishte një homoseksual! Sapo kthehet në Francë, Genet fillon nga vjedhjet e tij, të librave të rrallë, të cilat i shiste tek "bukinistët" e Senës


apo objekteve të vogla si në "Samaritaine", çarçafë etj. Rreth dhjetë dënime me burg nga viti 1938 më 1943. Pikërisht në burgun e Fresnes, pranë Parisit, ashtu si markezi De Sade, autori i "Justinës", "Sodomës" etj, ai arriti të shkruante poemën e famshme të tij "Le condamné à mort" (I dënuari me vdekje) dedikuar shokut të tij të burgut, Maurice Pilorge – të dënuar me vdekje, të cilit i pritët koka në gjyotinë më 17 mars 1939, çka hajdutin Genet e tronditi shumë.

Por, meqë ai kishte përdorur letrat e administratës së burgut për të shkruar, kur e kishin thërritur në Pallatin e Drejtësisë për një vjedhje të mëparshme, shkrimet ia gjejnë dhe i zhdukin. Atëherë iu desh ta shkruaj dhe njëherë "Notre-Dame-en-fleurs", një nga kryeveprat e tij, ashtu siç e mbante mend, kësaj radhe në fletore. Ishte kjo fletore që doli nga burgu, u shtyp dhe ra në dorë të shkrimtarit e poetit të famshëm Jean Cocteau. "Nganjëherë më ndodh një mrekulli", kishte shkruar ai, duke folur për mbresat e mëdha të leximit të kësaj poeme të gjatë. Cocteau e merr në mbrojtje dhe ia prezantoi Sartrit. André Gide e të tjerë, më pas dhe Colette e Beauvoir, thoshin se ishte një talent i jashtëzakonshëm. Dhem ashtu ishte. Por, ai do të vidhte sërish dhe e vetmja mbështetje për të ishte Cocteau, i cili mori përsipër të gjitha shpenzimet dhe ditën e gjykimit të tij, për vjedhjen e një koleksioni librash "Festat galante" të poetit Paul Verlaine. Por, ai do të dënohej, edhe pse Cocteau ishte në radhën e parë në gjyq dhe u fliste gjykatësve se "ju po dënoni një Rimbaud" ... "një nga shkrimtarët më të

mëdhenj të epokës"! Kur e pyesnin për burgjet e tij, Genet përgjigjej: "Burgu nuk është thjesht një burg, por është dhe një vend i shkëputjes, evazionit, është vetë liria. Atje ti i largohesh botës për të shkruar thelbësoren e jetës" ...

Cocteau e lexoi me një etje të madhe "Notre-Dame-des-Fleurs". Në ditarin e tij ai do të shkruante: "Bomba Genet. Libri është aty, në dhomë, i tmerrshëm, i pamoralshëm, i pabotueshëm, që s'mund t'i shmangesh. Nuk dimë si ta gjykojmë. Ai është, do të jetë ... Për mua është një ngjarje e madhe e epokës. Libri më revoltonte, më neverit dhe më mrekullonte ... Genet ju sikletos, ju shqetëson. Por, ai ka të drejtë dhe pjesa tjetër e botës gabon. Vallë, madhështia e vërtetë qëndron që të bësh si Mikelandelo? Të mashtrosh Papën, të mashtrosh Zotin? Të mbushësh me të fshehta kubetë e kishave dhe sheshet publike. Proust-i a do të ishte aq i madh dhe i qëndrueshëm po të mos gënjente? Gjithçka në këtë libër është e urryer dhe prestigjioze njëkohësisht ..."

Pikërisht ky shkrimtar i madh, hajdut dhe homoseksual, më pas do të gjente udhën e jetës së tij dhe do të jetë një intelektual i angazhuar jo vetëm në Francë, por dhe në botë në luftën kundër racizmit, ndalimin e luftës në Vietnam, për çlirimin e guas etj. Vdiq në një hotel të thjeshtë të Parisit, "Jack's Hôtel", por do të varrosej, siç donte ai, në një fshat të Marokut, në Larashe, ku jetonte i dashuri i tij maroken, edhe pse pak vite më vonë i vodhën dhe atë gur varri ku ishte shkruar thjesht vetëm emri i tij: "Jean Genet".



Ponte fiton derbin prizrenas, Peja mposhti Yllin

PRIZREN, 25 SHTATOR - Në një ndeshje interesante dhe me kthesa, Ponte Prizreni ka shënuar fitore ndaj Bashkimit me rezultat 93:101 (18:23, 14:32, 37:16, 24:30), në xhiron e tretë të Prince Caffè Superligës. Ponte Prizreni për një nuancë ishte më i mirë se Bashkimi, duke e fituar çerekun e parë 18:23. Ponte dominoi totalisht në periudhën e dytë, sidomos me sulme të suksesshme, duke u shkëputur në 23 pikë, sa ishte rezultati pas pjesës së parë, 32:55. Por, atë që e bëri Ponte në periudhën e dytë, e bëri Bashkimi në periodën e tretë, duke bërë një rikthim sensacional në rezultat dhe duke afruar shifrat në 69:71, sa ishte



rezultati pas 30 minutash lojë. Megjithatë, në dhjetë minutat e fundit, Ponte krijoi epërsi, që e ruajti deri në fund, duke

triumfuar 93:101. Te Bashkimi u dalluan Altin Morina me 19 pikë e shtatë asistime dhe Fahro Alihoxhiq me 21 pikë e tetë

kërcime, kurse te Ponte u dalluan Wayne Arnold me 33 pikë dhe Urim Zenelaj me 13 pikë e 11 kërcime. Të dy skuadrat kanë nga një fitore e dy humbje. Peja ka shënuar fitoren e tretë në këtë edicion, duke mundur me përmbyseje kampionin, Golden Eagle Yllin me rezultat 73:57 (11:21, 13:9, 25:19, 24:8), në xhiron e tretë të elitës. Mysafirët e nisën ndeshjen më mirë, me një seri prej 2:10, e më pas duke e thelluar edhe më shumë epërsinë, në 6:21, ndërsa çereku i parë përfundoi 11:21. Vendasit dalëngadalë u rikthyen në periudhën e dytë, për të ngushtuar shifrat, edhe pse kjo pjesë u karakterizua me shumë

pak pikë të shënuara, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 24:30. Kampionët e Kosovës në periodën e tretë kishin epërsi deri në nëntë pikë, 29:38, por pejanët sërish u rikthyen, duke u zhvilluar një lojë e barabartë dhe rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 49:49. Dhjetë minutat e fundit ishin vendimtare. Pejanët këtë pjesë e nisën furishëm me një seri prej 13:1 dhe thelluan epërsinë me kalimin e minutave, duke triumfuar 73:57. Te Peja u dallua Bradley Waldow me 15 pikë dhe 13 kërcime, kurse te Ylli u dallua Henrik Sirko me 16 pikë e tetë kërcime.

Ante Zhivković fitues i maratonës 'Prishtina 2022', Erzen Zyberaj i dyti

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Atleti kroat Ante Zhivković ka fituar vendin e parë në maratonën "Prishtina 2022", ndërsa i dyti në këtë garë u rëndit Erzen Zyberaj e vendin e tretë e zuri Emin Grajqevci. Në këtë maratonë, të organizuar nga Federata e Atletikës e Kosovës, garuesit morën pjesë në disiplina të ndryshme si 5km, 10 km e deri në atë më të gjatën që ishte 42 kilometra, në të cilën doli fitues Zhivković. Vendi i parë në këtë maratonë u shpërblye me 500 euro, i dyti me 450, kurse i treti me 400. "Epo, ishte e

mrekullueshme, gara filloi mirë, ishte pak ngrohtë në fillim, kështu që nuk ishte shumë vapë, por para fundit kishte një tatëpjetë të vogël dhe dielli doli, kështu që 7 kilometrat e fundit ishin të vështira... Shtegu është i mirë, në 7 kilometrat e fundit ishte një tatëpjetë e lehtë, gjë që nuk e kam ditur deri sa e pashë mbrëmë pistën, do të thotë profilin e pistës, ndaj thjesht e prisja të ishte e vështirë, por mirë se fillimi ishte në orën 9, kështu që pjesa më e madhe e garës shkoi mirë", ka thënë Zhivković. Kurse, Zyberaj u

shpreh i lumtur që mori vendin e dytë në këtë maratonë edhe pse tha se angazhimi dhe pjesëmarrja nga gara të tjera ndërkombëtare ka bërë që në këtë maratonë të marrë pjesë pa pasur synime për të fituar. Ai premtoi se do të punojë shumë në këtë drejtim dhe që në të ardhmen të jetë në mesin e atletëve që synojnë medalje edhe në gara të tjera. "Për mua është kënaqësi që të marr pjesë në maratonën e Prishtinës për faktin që është hera e dytë që marr pjesë prej viti 2014, sepse unë nuk kam



qenë aktiv në vrapime kështu që për mua është ndjenjë e mirë. Realisht unë nuk kam qenë i fokusuar të marr pjesë në këtë garë për shkak se i kam pasur dy gara para një muaji, Kampionatin Botëror 100 kilometra në Berlin dhe në Itali në Kampionatin Botëror "Sky Runner", kështu që kam qenë shumë i ngarkuar fizikisht, mirëpo vetëm kam pasur dëshirë të marr pjesë. Për mua është fillimi, unë jam në proces, besoj dhe shpresoj që pas dy apo tre viteve do të jemi atje ku po shpresojmë të jemi", ka thënë Zyberaj.

Rahoveci fiton derbin interesant me Vushtrrinë



VUSHTRRI, 25 SHTATOR - Në palestrën "Jeton Tërstena - Tota" në Vushtrri të dielën është luajtur derbi i xhiros së dytë të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Në një atmosferë të bukur sportive, janë takuar

Vushtrria dhe Rahoveci. Ashtu si pritej, ndeshja ishte e fortë dhe me rivalitet. Të dy skuadrat kanë pretendime për pozitën e kreut në këtë kampionat dhe me paraqitjen e treguar kanë dëshmuar se janë në rrugën

e duhur. Megjithatë më shumë nga loja kishin "vreshtarët" që kanë fituar me rezultat 34:30. Pas pjesës së parë mysafirët kishin epërsi prej dy golave, ndërsa epërsinë konstante e kanë mbajtur deri në fund. Vushtrriasit e kthyer në

Superligë, kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për të kaluar në epërsi, duke e bërë ndeshjen interesante dhe të fortë deri në fund. Në ndeshjen tjetër të së dielës, Trepça ka shënuar fitore të pritur ndaj Deçanit me rezultat 34:21.

400 mijë euro për secilin lojtar nëse Gjermania shpallet kampione e botës

BERLIN, 25 SHTATOR - Federata Gjermane e Futbollit (DFB) njoftoi këtë të diel se çdo lojtar do të marrë 400 mijë euro, nëse Kombëtarja e Gjermanisë triumfon në Kampionatin Botëror "Katar 2022". Federata gjermane bëri të ditur se ka kontaktuar me futbollistët e Kombëtares A lidhur me skemën e premive për Botërorin e këtij

viti. Pas takimit mes drejtuesve të DFB-së dhe futbollistëve që përfaqësuan ekipin kombëtar; Manuel Neuer, Thomas Müller, Joshua Kimmich dhe Ilkay Gundogan, presidenti i shtëpisë gjermane të futbollit, Bernd Neuendorf, u shpreh: "Ne patëm bisedime intensive në një atmosferë të mirë dhe konstruktive. Në

fund, arritëm një zgjidhje të pranueshme për të gjithë të përfshirët". Bonuset do të paguhen në bazë të performancës. Çdo lojtar do të marrë 50 mijë euro si premi, nëse Gjermania e kalon grupin - kurse 100 mijë euro është premia për arritjen në çerekfinale dhe 150 mijë euro për arritjen deri në gjysmëfinale. Nëse

Gjermania përfundon si e treta në Kampionatin Botëror, lojtarët do të shpërblehen me nga 200 mijë euro. 250 mijë do t'u takojnë nëse dalin nënkampion. Premia kryesore është 400 mijë euro, shumë e cila do t'i dhurohej çdo futbollisti, nëse Gjermania shpallet kampione e botës. Kujtojmë se Kampionati Botëror



"Katar 2022" do të zhvillohet nga 21 nëntori deri më 18 dhjetor. Gjermani është shortuar në Grupin E, bashkë me Kosta Rikën, Japoninë dhe Spanjën.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Mbikëqyrës i Lartë Bankar (1 pozitë)
Departamenti/divizioni:	Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
Niveli i gradës:	5
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:

- Kryen ekzaminimet në vend dhe shqyrton raportet e bankave;
- Udhëheqë ekipin e ekzaminerëve në ekzaminimet në vend në banka;
- Planifikon, koordinon dhe udhëheqë resurset dhe kohën e nevojshme për ekzaminimet në vend në banka;
- Përcakton fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe identifikon masat detyruese pas ekzaminimit, ndaj bankave;
- Përpilon raportet e ekzaminimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e draft raporteve të përgatitura nga ekzaminerët bankarë për fushat e tyre të përgjegjësisë, në ekzaminimet në vend në banka;
- Përgatitë strategjitë mbikëqyrëse konform profilin të rrezikut të bankave dhe i rekomandon mbikëqyrësit shpeshësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve në vend;
- Identifikon rreziqet dhe veprimet detyruese si dhe rekomandon përshtatjen e strategjive mbikëqyrëse të bankave;
- Monitoron performancën financiare, zbatimin e rekomandimeve, kërkesat nga ekzaminimet në vend, si dhe zbatimin e masave detyruese të shqiptuara ndaj bankave;
- Sipas kërkesës së drejtorit të departamentit, merr pjesë në ekzaminime dhe kur kërkohet udhëheqë ekzaminimet në vend edhe për IMF – IFJB;
- Udhëzon dhe bartë njohuritë tek mbikëqyrësit bankar dhe mbikëqyrësit e ri bankar;
- Ndihmon në përpilimin e politikave, rregulloreve, udhëzimeve, si dhe procedurave të brendshme tjera të punës;
- Detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi në kuadër të përgjegjësi të Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare.

Edukimi:

- Të ketë të kryer fakultetin në fushën e ekonomisë, financave, kontabilitetit, matematikës, ose të ngjashme;
- Preferohet të ketë diplomë/certifikatë në fushën e kontabilitetit ose auditimit;
- Njohja e kornizës së Bazelit, standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes së bankave si dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) paraqesin përparësi;
- Preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze.

Përvoja e punës:

- Të ketë minimum 3 vjet përvojë pune në sektorin financiar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **10 tetor 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Pozicija:	Viši bankarski nadzornik (1 pozicija)
Odeljenje/odsek:	Odeljenje bankarskog nadzora
Nivo stepena:	5
Izveštava:	Rukovodiocu Divizije nadzora na licu mesta

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Vršiti kontrolu na licu mesta i pregleda bankarske izveštaje;
- Rukovodi timom ekzaminera u kontroli na licu mesta u bankama;
- Planira, koordinira i upravlja resursima i vremenom potrebnim za kontrole na licu mesta u bankama;
- Utvrđuje delokrug kontrola na licu mesta i identifikuje obavezne mere nakon kontrole, prema bankama;
- Sastavlja izveštaje o kontroli i ocenjuje adekvatnost nacrtu izveštaja koje su bankovni ekzaminer pripremili za svoje oblasti odgovornosti, u okviru kontrola na licu mesta u bankama;
- Priprema i strategije nadzora u skladu sa profilom rizika banaka i preporučuje nadzorniku učestalost i delokrug kontrola na licu mesta;
- Identifikuje rizike i prinudne mere i preporučuje prilagođavanje nadzornih strategija banaka;
- Prati finansijski učinak, sprovođenje preporuka, zahteva iz kontrola na licu mesta, kao i sprovođenje prinudnih mera izrečenih bankama;
- Na zahtev direktora odeljenja učestvuje u kontrolama i po potrebi vodi kontrole na licu mesta i za MFI - NBFi;
- Upućuje i prenosi znanje bankarskim nadzornicima i mlađim bankarskim nadzornicima;
- Pomaže u izradi politika, uredbi, uputstava kao i drugih internih radnih procedura;
- Druge zadatke koje je odredio nadzornik u okviru odgovornosti Odeljenja bankarskog nadzora.

Obrazovanje:

- Da ima završen fakultet u oblasti ekonomije, finansija, računovodstva, matematike, ili slično;
- Poželjno je imati diplomu/sertifikat u oblasti računovodstva ili revizije.
- Poznavanje Bazelskog okvira, međunarodnih standarda bankarskog nadzora kao i međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI) je prednost;
- Poželjno je znanje engleskog jezika.

Radno iskustvo:

- Da ima najmanje 3 godine radnog iskustva u finansijskom sektoru.

Svi kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK -a za apliciranje;
- Prateće pismo (motivacijsko) gde je naglašen interes za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate / nostrifikovane od strane MONT -a;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije
- Izveštaj iz Trusta koji dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu;

Procedura apliciranja:

- Zadnji rok za apliciranje je **10 oktobar 2022**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK -a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem službene internet stranice: www.bqk-kos.org
- **Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

